

Akt Themelimi

i shoqërisë tregtare **“FOCUS ARCHITECTURE” shpk**

Sot më datë 22.01.2019, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortakët :

1. **Z. Enkelejd KARANXHA**, i biri i Sotiraq-it, i dtl. 13.05.1978, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, Rruga: “Mihal Grameno”, pall. 4, ap 5, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar.
2. **Z. Gentian PARRUCA**, i biri i Bardhyl-it, i dtl.05.07.1978, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, Bulevardi: “Zogu I”, pall. 62/1, ap.10, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi jurdike dhe për të vepruar.

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **“FOCUS ARCHITECTURE” sh.p.k.**

Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private **“FOCUS ARCHITECTURE” sh.p.k.** do të ketë selinë e saj, në rrugën **“BABE REXHA”**, pall.5, ap. 7, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.



Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- 3.1 Studime pjesore urbanistike.
- 3.2 Projektim arkitektonik për objekte civile – industriale – turistike vepra arti ne infrastrukture.
- 3.3 Projektim interiere.
- 3.4 Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe
- 3.5 Konsulence dhe supervizion ne fushen e arkitektures

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat te pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private **“FOCUS-ARCHITECTURE”** sh.p.k., do të jetë 100.000 (njëqind mijë lekë). Kapitali është 50% nga kuotat e çdo ortakut, e ndarë në 2 kuota .

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqesuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt themelimi, rregullohen në Statutin e Shoqërisë si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.

Neni 11


Akti i themelimit, u përpilua në 5 kopje, për t’ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **“FOCUS ARCHITECTURE”** sh.p.k.

Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët e Shoqërisë

“FOCUS ARCHITECTURE” sh.p.k.

Enkelejd KARANXHA



Gentian PARRUCA

